



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e premte, datë 12 korrik 2024, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës për heqjen/konstatimin e pavlefshmërisë së licencës, për shoqërinë “MCN24” sh.p.k., licencuar për subjektin audioviziv “MCNtv”. **(Vendim nr. 78, datë 12.07.2024)**
2. Zgjerimin e zonës së licencimit të shoqërisë “Radio Shqip” sh.p.k., licencuar për shërbimin e programit audio privat rajonal “Radio Shqip”, në “Qarkun Lezhë, Shkodër dhe Kukës”. **(Vendim nr. 79, datë 12.07.2024)**
3. Zgjerimin e zonës së licencimit të shoqërisë “Radio Logos” sh.p.k., licencuar për shërbimin e programit audio privat rajonal “Radio Logos”, në “Bashkitë Dibër dhe Bulqizë”. **(Vendim nr. 80, datë 12.07.2024)**
4. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Wave” sh.p.k., licencuar për subjektin audio privat rajonal “Radio Alpet”, për ndryshimin e emërimit të subjektit audio nga “Radio Alpet” në “Radio Wave”. **(Vendim nr. 81, datë 12.07.2024)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 12 korrik 2024